

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA TË LICENSUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

KAPITULLI I Dispozita të Përgjithshme

Neni 1 *Autoriteti*

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 24 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe në përputhje me përgjegjësitë e ERE-s të parashikuara nga nenet 8, pika 2, gërma “c” dhe 22, pika 1, gërma “c” të këtij ligji.

Neni 2 *Objekti*

Objekt i kësaj rregulloreje janë procedurat e paraqitjes dhe miratimit nga ERE të planit të investimeve të të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3 *Qëllimi*

Të përcaktojë mënyren, formën dhe afatet e paraqitjes në ERE të planeve të investimeve nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike si dhe kriteret e analizës së vlerësimit dhe miratimit të tyre nga ERE për të garantuar që planet e investimeve janë në përputhje me parimet e planifikimit me koston më të ulët.

Neni 4 *Zbatimi*

Kjo rregullore aplikohet për të gjithë të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët kanë marrë licensë për një nga veprimtaritë e mëposhtme:

- Prodhimin e energjisë elektrike të destinuar për tregun e klientëve tariforë.
- Transmetimin e energjisë elektrike.
- Shpërndarjen e energjisë elektrike.

Neni 5

Përcaktime

Termat e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhteme:

1. **“Ligj”** do të thotë Ligji Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” me të gjitha ndryshimet përkatëse.
2. **“Bordi i Komisionerëve”** do të thotë organi vendimarrës i ERE-s, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
3. **“ERE”** do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.
4. **“Aset”** do të thotë aktivi afatgjatë material, që përdoret nga i licensuari dhe që i shërben realizimit të një prej aktiviteteve të prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit.
5. **“Biznes”** do të thotë veprimtari e licensuar nga ERE për shërbimet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.
6. **“Investim”** do të thotë tërësia e shpenzimeve, që kryhen nga një i licensuar për të shtuar vlerën e aseteve, që përdoret për kryerjen e veprimtarisë së licensuar.
7. **“Plan i investimeve”** do të thotë paraqitja e shpenzimeve kapitale sipas projekteve dhe/apo grupit të aseteve për një periudhë rregullimi.
8. **“Person”** do të thotë çdo person fizik ose juridik, Qeveria ose çdo agjensi shtetërore, çdo autoritet lokal ose ente të tjera juridike të njohura nga ligji, përveç ERE-s.
9. **“Liçensë”** do të thotë një autorizim i dhënë nga ERE-ja, një personi për të operuar në sektorin e energjisë elektrike në përputhje me dispozitat që kërkohen nga Ligjit nr. 9072, 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe procedurave të licensimit të ERE-s.
10. **“I licensuar”** do të thotë një person, që mban një liçensë të dhënë nga ERE. Për një nga veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
11. **“Baza e Rregulluar e Aseteve” (RAB)** do të thotë vlera e aseteve fikse, që zotërohen nga shoqëria dhe që përdoren për të kryer një nga veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

12. “Periudha rregullatore” do të thotë periudha gjatë së cilës tarifat e reja bëhen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit të marrë nga ERE.

KAPITULLI II

Planet e Investimeve

Neni 6

Kërkesa të Përgjithshme të hartimit të planeve të investimeve

Në hartimin e planeve të investimeve të licensuarit do të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme:

- Planet e investimeve do të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve, rregulloreve, metodikave dhe të gjitha akteve nenligjore perkatëse, që rregullojnë studimet, projektimet dhe kryerjen e investimeve, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe të sigurisë kombetare. Planet e investimit duhet të jenë në harmoni me strategjitë kombetare të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike.
- Planet e investimeve duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë efektivitet të lartë, kosto të ulët, përfshirë marrjen parasysh të masave për menaxhimin e kërkesës për energji elektrike.
- Planet e investimeve duhet të marrin parasysh marrdhëniet që i licensuari ka me pjesëmarrësit e tjerë të tregut për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik si dhe plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve.
- Planet e investimeve do të jenë të hapura për publikun duke ju dhënë mundësinë të interesuarve përfaqësojë dhe institucionet e ndryshme shtetërore të japin komentet e tyre lidhur me këto plane.

Neni 7

Përgjegjësitë e të licensuarve

1. Çdo i licensuar në referencë të Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe në zbatim të licensës përkatëse të marrë nga ERE, është përgjegjës për hartimin e një plani investimi sipas periudhave të

rregullimit dhe për çdo vit pasardhës për të plotësuar nevojat e klientëve me energji elektrike. Planet e investimeve do të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili do të përfshijë edhe paraqitjen tabelare dhe grafike të të dhënave referuese dhe një plan kohor zbatimi.

2. Të licensuarit në veprimtaritë e prodhimit, publik, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në fund të çdo periudhe rregullimi do të paraqesin planet e tyre të investimeve për periudhën rregullatore pasardhëse.
3. Të licensuarit do të paraqesin në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit paraardhës duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo ndryshim në plan. Ky raportim do të bëhet jo më vonë se data 30 Qershor e vitit në vijim.

Neni 8

Planet e investimeve për të licensuarit në veprimtaritë e prodhimit të energjisë elektrike

1. Planet e investimeve të të licensuarve në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike mbështeten në planifikimin e sasisë vjetore të energjisë elektrike për t'u prodhuar, i cili do të bëhet sipas dispozitave të Pjesës së II-të, Paragrafi 2.6, pika 2.6.1 të Kodit të Transmetimit.
2. Planet e investimeve për prodhuesit e energjisë elektrike mund të përmbajnë investime për:
 - Centrale/njësi të reja prodhuese.
 - Rehabilitim dhe modernizim të centraleve ekzistuese.
 - Nxjerrje nga puna të njësive të vjetra.
 - Rritje të kapaciteteve ekzistuese.
3. Çdo prodhues i licensuar, përveç të dhënave të detajuara të planifikimit teknik sipas Shtojcës A, Pjesa 2 të Kodit të Transmetimit, në planin e investimeve do të paraqesë edhe treguesit e mëposhtëm:
 - Kapacitetin nominal të çentralit gjenerues të ri /apo të rehabilituar.
 - Sasinë e energjisë elektrike, që pritet të prodhohet nëse do të punonte me kapacitet të plotë.

- Faktorin e disponibilitetit, që merr në konsideratë kohën që çentrali është i disponueshëm për të gjeneruar energji elektrike gjatë vitit.
- Periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit.
- Periudhën e pritshme të shlyerjes së investimit.
- Burimet e sigurimit të lëndës së parë për prodhimin e energjisë elektrike.
- Efiçencën energjitike, e cila merr në konsideratë llojin e teknologjisë, pajisjet, makineritë dhe lëndën djegëse.

Neni 9

Planet e investimeve për të licensuarit në veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike

Planet e investimeve për të licensuarin në transmetimin e energjisë elektrike duhet të përmbajnë investime që synojnë:

- Përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së tij dhe sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike.
 - Reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit.
 - Rritjen e mundësisë për shpërndarjen dhe kontrollin në distancë të flukseve të energjisë elektrike.
2. Në planifikimin e investimeve për të plotësuar synimet e mësipërme, i licensuari duhet të bazohet dhe të respektojë:
- Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të transmetimit të përcaktuara në Kodin e Transmetimit si dhe procedurat e parashikuara për zhvillimin e sistemit të transmetimit sipas pjesës së 2-të të tij (Kodi i Transmetimit).
 - Informacionet dhe të dhënat e siguruar nga operatorët e tregut dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit.
 - Kriteret e projektimit të elementëve kryesorë të rrjetit të transmetimit (linja dhe nënstacione).
 - Periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit të një objekti.

3. Në planin e investimeve të parashikuar, i licensuari duhet të pasqyrojë listën e projekteve që do të zbatohet.
4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:
 - a. Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik duke i paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike.
 - b. Ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e humbjeve teknike etj.
 - c. Kostot, burimet e financimit, periudhat e shlyerjes së investimeve etj.

Neni 10

Planet e investimeve për të licensuarit në veprimtarinë e shpërndarjes së energjisë elektrike

1. Planet e investimeve për të licensuarit në shpërndarjen e energjisë elektrike duhet të përmbajnë investime që synojnë:
 - Rritjen e shkallës së sigurisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.
 - Zvogëlimin e humbjeve teknike dhe jo teknike në rrjetin e shpërndarjes.
 - Mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuar në Kodin e Shpërndarjes.
 - Plotësimin dhe modernizimin e sistemit të matjes së energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes.
2. Në hartimin e planeve të investimeve i licensuari duhet të bazohet dhe të respektojë:
 - Kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes të përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes si dhe procedurat e parashikuara në Kapitullin 2 të Kodit të Shpërndarjes (Planifikimi).
 - Studimi i ngarkesave ekzistuese dhe parashikimi i zhvillimit të ngarkesave në të ardhmen.
 - Informacionet dhe të dhënat e siguruar nga OST-ja, pjesëmarrësit e tregut dhe klientët kryesorë të lidhur me sistemin e shpërndarjes.
 - Kriteret e projektimit të elementëve kryesorë të rrjetit të shpërndarjes (nënstacione, kabina transformimi, linja shpërndarëse të TM dhe TU etj).

- Periudhat kohore të zbatimit të investimit për ndërtimin apo rehabilitimin e një objekti.
3. Në planin e investimeve të parashikuara, i licensuari duhet të pasqyrojë listën e projekteve, që do të zbatohet.
 4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:
 - a. Metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik sipas kushtit n-1 duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e nënstacioneve (TL/TM), kabinave të transformimit, pajisjeve rregulluese të tensionit, etj.
 - b. Ndikimet e investimit në përmirësimin e humbjeve në rrjet dhe treguesve të tjerë të performancës, etj (Krahasimi i humbjeve para dhe pas investimit).
 - c. Kostot, burimet e financimit, periudhat e shlyerjes së investimeve etj.

KAPITULLI III

Procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve

Neni 11

Procedura e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve

1. Një procedurë për miratimin e planit të investimeve fillon me paraqitjen e një kërkesë për miratim të planit të investimeve nga një person mbajtës i një license të dhënë nga ERE se bashku me një plan të detajuar investimesh sipas dispozitave të parashikuara në nenet 8, 9, 10 si dhe shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.
2. Nëse informacioni për planin e investimeve është dhënë konform kërkesave të përcaktuara në këtë Rregullore, Bordi i Komisionerëve të ERE merr vendim për fillim procedurë të shqyrtimit të planit të investimeve.
3. ERE pasi shqyrton planin e investimeve dhe nëse e gjen atë në përputhje me kërkesat e lartpërmendura, e miraton tërësisht ose pjesërisht atë.

Neni 12

Afatet e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve

1. ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje. Të licencuarit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës jo më vonë se data 15 korrik.
2. ERE publikon njoftimin për paraqitjen e planit të investimeve nga i licencuari jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të aplikimit për marrjen e komenteve nga të interesuarit. Të interesuarit mund të paraqesin komentet e tyre brenda 15 ditëve nga publikimi.
3. ERE mund të kërkojë sqarime ose të bëjë pyetje lidhur me planin e investimeve të paraqitur nga i licencuari, nga dita e paraqitjes së tij deri në fund të muajit korrik.
4. Brenda datës 10 gusht, ERE mund të organizojë seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.
5. ERE shqyrton dhe merr vendim për miratimin e plotë ose të pjesshëm të planit të investimeve brenda datës 20 gusht.

Neni 13

Kriteret për miratimin e planit të investimeve

1. ERE mund të miratojë Planin e Investimeve në tërësi ose në mënyrë të pjesshme sipas përparësisë së projekteve. Informacioni i paraqitur në planin e investimeve përdoret nga ERE për të përcaktuar Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB) të veprimtarive të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
2. Në miratimin e planit të investimeve ERE merr në konsideratë:
 - Nëse plani përmirëson nivelin dhe cilësinë e shërbimit.
 - Nëse plani është në gjendje të përmirësojë dhe reduktojë humbjet teknike dhe joteknike.
 - Nëse plani përmban dhe reflekton masat për minimizimin e kostos duke përfshirë praktikën transparente dhe të drejtë të blerjeve.
 - Nëse plani është mjaftueshëm i detajuar, i dokumentuar dhe konsiston në një shkallë të duhur fleksibiliteti në zbatim.

- Nëse plani i investimeve ka analizuar dhe vlerësuar disa alternativa dhe ka argumentuar faktin se pse alternativat e tjera nuk janë përfshirë.
 - Nëse plani i investimeve është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike.
3. Nëse ERE e sheh të arsyeshme mund të kërkojë kryerjen e një oponente për vlerësimin e aspekteve teknike dhe eficiencën ekonomike të investimit.

Neni 14 ***Njoftimi për Vendimin***

1. Brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit ERE do të njoftojë të licencuarin si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit.
2. Vendimi i Bordit të Komisionerëve për miratimin e planit të investimeve për të licencuarit publikohet në Fletoren Zyrtare.
3. Brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, i licencuari ka të drejtë të paraqesë ankim në ERE konform Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s.

KAPITULLI IV **Dispozita të tjera**

Neni 15 ***Informacioni konfidencial***

Në rast se ndonjë i licencuar pretendon se plani i investimeve të tij përmban një numër informacionesh dhe të dhënash, që ai i konsideron konfidenciale, ai do t'i shënojë si konfidenciale kur paraqet planet e investimeve dhe të tilla informacione dhe të dhëna do të trajtohen nga ana e ERE-s, sipas rregullave dhe procedurave që aplikohen për këto lloje informacionesh dhe të dhënash.

Neni 16
Ankimi gjyqësor

Kundër Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për miratimin ose jo të planit të investimeve, i licensuari mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

KAPITULLI V
Dispozita të Fundit
Neni 17
Dispozitë kalimtare

Plani i investimeve për vitin 2010 do të paraqitet nga i licensuari në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifën e vitit 2010.

Neni 18
Amendamente të Rregullores

Kjo Rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në përputhje me Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjehere.

Kjo rregullore botohet në Fletoren Zyrtare.

Shtojce 1: Tabela e Investimeve per vitin _____

Pershkrimi i Grupit te Aseteve (ne perputhje me Listen e Llogarive)	Numri i Llogarise	Koha e venies ne pune	Vlera e Kapitalizuar (per t'u perfshire ne RAB)	Jetegjatesia e pritshme	Amortizimi vjetor i pritshem